



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**EMRI I ORGANIZATËS BUXHETORE - KOMUNA E DRAGASHIT  
EMRI I ORGANIZATËS BUXHETORE -OPŠTINA DRAGAŠ**

**EMRI I ORGANIZATËS BUXHETORE - DRAGASH MUNICIPALITY**

---

**RREGULLORE**

**Mbi ndryshimin dhe plotësimin e rregullores mbi lartësinë e  
taksave,ngarkesave dhe gjobave komunale**

**Dragash,03.05. 2012**

Në bazë të nenit 17 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.03/L-040,)nenit 10 të Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.03/L-049),nenit 32 pika 2 e Statutit të Komunës së Dragashit,Kuvendi i Komunës së Dragashit ,në seancen e mbajtur më 03.05.2012, miraton këtë:

## **RREGULLORE**

### **MBINDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES MBI LARTËSINË E TAKSAVE NGARKESAVE DHE GJOBAVE KOMUNALE**

Në Rregulloren mbi lartësinë e taksave ,ngarkesave dhe gjobave komunale o1 Nr.06-117/1 prej 16.07.2009, pas nenit 5 shtohet :

#### **Neni 5a**

Të gjitha bizneset individuale të cilat regjistrohen në regjistrin e bizneseve ,nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore ,do të lirohen nga obligimi i pagesës së taksës komunale në afarizëm të përcaktuar me skemen tarifore të Rregullores 01 Nr.117/1 në afat prej 3 vitesh.

#### **Neni 5b**

Drejtorati për Ekonomi,Financa dhe Zhvillim –Njisia për Taksa Komunale dhe Njisia për regjistrimin e bizneseve obligohen që të mbajn evidencë të posaçme mbi bizneset individuale të cilat lirohen nga obligimi i pagesës së taksës komunale.

#### **Neni 5c**

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit të saj nga Kuvendi Komunal.

01.Nr.06-649/1

Dt.03.05.2012

**KRYESUESI I KUVENDIT**

Lulzim Rifaj

